



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 22, datë 25.02.2021**

**PËR  
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR TË  
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të nenit 11, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e programit të transparencës të rishikuar të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet koordinatori për të drejtën e informimit për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR  
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**